



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/47
Podujevë,
16.03. 2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik (MPMS), Drejtoria për Arsimit shpallë:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Pozita: Punëtor teknik – pastrues,

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë,

Numri i pozitave: një (1) ekzekutues,

Vendi i punës:

- Një (1) punëtor teknik – pastrues në gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” Podujevë,
- Një (1) punëtor teknik – pastrues në SHMLT “Fan S Noli” Podujevë,
- Një (1) punëtor teknik – pastrues në shfmu “Jetullah Gashi” Dobërdol,
- Një (1) punëtor teknik – pastrues në shfmu “Drita” Lupç i Epërm,
- Një (1) punëtor teknik – pastrues në shfmu “Sheqë Mirofci” Shtedim,
- Një (1) punëtor teknik – pastrues në shfmu “Kadri Kadriu” Llaushë,
- Një (1) punëtor teknik – pastrues në shfmu “Luigj Gurakuqi” Batllavë

Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruajë mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe, sipas nevojës, t’ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;

- Të përkujdeset për sanimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për sanimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

I. KUSHTET:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin bazik.

II. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra e komunës nr. 14),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin,
- Dëshmi që nuk jeni i ndjekur penalisht,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranojnë në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).

- **Sqarim shtesë:**

- Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
- Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit,
- Intervista me kandidatë për punëtor teknik mbahet në SHFMU “Shaban Shala” në Podujevë, sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranojnë, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen,
- Dokumentet nuk kthehen.

- **Afati i konkursit:**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, gjegjësisht deri më datën 31.03.2018.

Agim Blakçori,
u.d. i drejtori të DKA-së

